



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr 1061/1 Prot.

Tiranë, më 12/04 /2025

V E N D I M

Nr. 12, datë 17.04.2025

P Ë R

**MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË STUDIMIT TË
CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, BACHELOR NË INXHINIERI TË SISTEMEVE
ELEKTRONIKE, DIPLOMË E DYFISHTË, MIDIS UNIVERSITETIT POLITEKNIK
TË TIRANËS DHE UNIVERSITETIT TEKNOLOGJIK TË COMPIEGNE (UTC)
FRANCË, PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, gërma dh, neni 80, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Vendimin e Departamentit të Elektronikës dhe Telekomunikacionit Nr. 9, datë 07.03.2025 dhe në Vendimin e Dekanatit të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit Nr. 19, datë 26.03.2025, Senati Akademik në mbledhjen e datës 17.04.2025,

VENDOSI:

Miratimin e hapjes së programit të përbashkët të ciklit të parë të studimeve, Bachelor në "Inxhinieri të Sistemeve Elektronike", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e dyfishtë, e cila ofrohet nga Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit, të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, të Universitetit Politeknik të Tiranës, në bashkëpunim me Universitetin Teknologjik të Compiegne (UTC) Francë, për vitin akademik 2025-2026.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë,

KRYETARI

Prof. Dr. Akli Fundo

